



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova**  
**Republic of Kosova**



**Komuna e Kaçanikut**  
**Opština Kacanik**  
**Municipal Kacanik**

01Nr. 06-350-9420/15  
Kaçanik, 28. 04. 2015

Në bazë të nenit 12, të Ligjit 03/L-040 –Për Vetëqeverisjen Lokale ( Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), të nenit 15 pika 1.2 e Ligjit Nr. 04/L-110 - Për ndërtimin, të nenit 5, pika 3.16 të Udhëzimit Administrativ të MMPH Nr. 09/2013 -Për Kategorizimin e ndërtimeve, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e mbajtur me 28.04.2015, mori këtë:

**V E N D I M**  
**PËR DHËNIEN E PËLQIMIT KOMPANISË “2 KORRIKU ” NGA SOPONICA PËR**  
**NDËRTIMIN E HIDROCENTRALIT “SOPONICA” ME KAPACITET 1.3 MW NË**  
**LUMIN LEPENC**

1. Me këtë Vendim, i Jepet PËLQIMI, kompanisë “2 Korriku” Sh.p.k. nga f. Soponicë-me pronar, Ejup Kovaqi, për ndërtimin e Hidrocentralit, “ SOPONICA” me kapacitet 1.3 MW, në lumin Lepenc në fshatin Soponicë dhe Doganaj.
2. Hidrocentrali – objekti do të ndërtohet në ngastrën kadastrale Nr. 266, e evidentuar me certifikatën Nr. 714-9416/2015, lëshuar me datë 19.03.2015, të Z. K-le Doganaj, pronë private e Ejup Kovaqit, ndërsa shtrirja e tubacioneve do të bëhet në pjesën e ngastrës kadastrale Nr. 1399-1, e evidentuar si pasuri shtetërore e Kosovës- UJËRAT.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Kryetari i komunës dhe drejtorja për Urbanizëm, Kadasër dhe Mbrojtje të Mjedisit.
4. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokolit të MAPL si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

Me këtë Vendim njoftohen:

1. Kryetari i Komunës,
2. Drejtorja për Urbanizëm, Kadasër dhe Mbrojtje të Mjedisit( përmes saj njoftohen organet tjera relevante),
3. Drejtorja për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural,
4. Drejtorja e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës, dhe
5. Arkiva.



Kryesuesi i Kuvendit  
Xhelal Gashi